



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0519

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105,106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP), në përbërje nga Vjosa Gradinaj Mexhuani-Kryetare, Batisha Ibrahim-Referuese dhe Vedat Poterqoi -Anëtar, duke vendosur sipas ankesës me Nr. 2024/0519, e datës 18.06.2024 të parashtruar nga Operatorit Ekonomik EBK SH.P.K., kundër vendimit për dhënie të kontratës, lidhur meaktivitetin e prokurimit: “LOT 1 –Vazhdim i Punimeve “Qendra për Vlerësim dhe Standarde - QVS “- Prishtinë - Faza II-të dhe LOT 2 -Vazhdimi i Punimeve Akademia e Drejtësisë Ad - Prishtinë - Faza II-të” Me Nr. të Prokurimit: "214-23-6442-5-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues – Ministria e Punëve të Brendshme, me datën 22.07.2024, mori këtë:

Vendim

1. Hedhet e palejuar ankesa me nr. 2024/0519 e datës 18.06.2024 e Operatorit Ekonomik (OE) EBK SH.P.K., kundër vendimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “LOT 1 –Vazhdim i Punimeve “Qendra për Vlerësim dhe Standarde - QVS “- Prishtinë - Faza II-të dhe LOT 2 -Vazhdimi i Punimeve Akademia e Drejtësisë Ad - Prishtinë - Faza II-të” Me Nr. të Prokurimit: "214-23-6442-5-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues – Ministria e Punëve të Brendshme.
2. Mbetet në fuqi, vendimi për dhënie të kontratës i AK-së, i datës 27.05.2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “LOT 1 –Vazhdim i Punimeve “Qendra për Vlerësim dhe Standarde - QVS “- Prishtinë - Faza II-të dhe LOT 2 -Vazhdimi i Punimeve Akademia e Drejtësisë Ad - Prishtinë - Faza II-të” Me Nr. të Prokurimit: "214-23-6442-5-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues – Ministria e Punëve të Brendshme.
3. Në përputhje me Rregulloren e Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues EBK SH.P.K., i kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimin të ankesës.

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Ministria e Punëve të Brendshme, në cilësinë e autoritetit kontraktues me datën 23.06.2023, ka publikuar Njoftimin për Kontratë, për të cilën afati i fundit për dorëzimin e tenderëve ishte me datë 07.08.2023, për aktivitetin e prokurimit me titull: "LOT 1 –Vazhdim i Punimeve "Qendra për Vlerësim dhe Standarde - QVS "- Prishtinë - Faza II-të dhe LOT 2 -Vazhdimi i Punimeve Akademia e Drejtësisë Ad - Prishtinë - Faza II-të" Me Nr. të Prokurimit: "214-23-6442-5-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues – Ministria e Punëve të Brendshme.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: Punë.

Me 03.06.2024, OE ankues **EBK SH.P.K.** ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim, ndërsa me datë 05.06.2024, (AK) **Ministria e Punëve të Brendshme**, e ka refuzuar si të pa pabazuar kërkesën për rishqyrtim të Operatorit Ekonomik ankues, për aktivitetin e prokurimit të shënuar si më lart.

Ankuesi i pakënaqur me vendimin e AK-së, lidhur me vendimin e kërkesës për rishqyrtim, me 18.06.2024, konform nenit 108/A ka parashtruar ankesë ne OSHP me numër të protokollit: 2024/0519.

Organi Shqyrtues i Prokurimit me 08.07.2024, ka njoftuar OE ankues **EBK SH.P.K.**, me raportin e ekspertizës.

AK–**Ministria e Punëve të Brendshme**, ka deklaruar se pajtohet me mendimin e ekspertës shqyrtuese (raportin e ekspertizës me nr. 2024/0519), ndërkaq, OE **EBK SH.P.K.** ka deklaruar se nuk pajtohet me mendimin e Ekspertes shqyrtuese.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Organi Shqyrtues i Prokurimit në pajtim nenin 113 të LPP-së, ka autorizuar ekspertja shqyrtuese të prokurimit që, të bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes së tenderit, vendimi për dhënie të kontratës dhe pretendimeve ankimore, me të cilin me datës 08.07.2024, ekspertja shqyrtuese ka rekomanduar ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, ndërsa vendimi për dhënie të kontratës të mbetet në fuqi.

Paneli Shqyrtues konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, konform nenit 24 paragrafi 1, të Rregullores së Punës së OSHP, përderisa pretendimet e palëve, provat, parashtresat e tyre dhe ekspertiza nr. 2024/0519 e ekspertës shqyrtuese, ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues "**EBK SH.P.K.**", janë parashtruar si në vijim:

Operatori Ekonomik (OE) ankues konstaton se ka ndodhur shkelje e Nenit 1 të Ligjit të Prokurimit Publik (LPP) në Kosovë, duke argumentuar se Autoriteti Kontraktues (AK) ka anuluar ofertën e tyre të vlerësuar në 106,976.85 euro, duke e zëvendësuar me një ofertë fituese që është shumë më e lartë se oferta e tyre. Ndërsa tek pretendimi numër dy OE ankues pretendon se ka ndodhur diskriminim dhe favorizim i operatorit tjetër fitues në procedurën e prokurimit. Ankesa e tyre për ri-shqyrtim është pranuar, dhe sipas tyre është konstatuar se oferta e tyre ishte e përgjegjshme. Megjithatë, AK në vendim e ka shpallur ofertën e tyre si të papërgjegjshme, duke krijuar dualizëm dhe vlerësim të paanshëm. Tek pretendimi numër tre AK në vendimin për

refuzim e ka shpallur ofertën e OE ankuesit si të papërgjegjshme, megjithëse në rishqyrtimin e kërkuar, kjo ofertë është konstatuar e përgjegjshme. Megjithatë, në vendim më pas, AK e ka argumentuar se nuk ka vazhduar sigurimin e tenderit, duke mos e kërkuar nga grupi i OE për një periudhë të caktuar. Te pretendimi i katërt AK nuk ka kërkuar vazhdimin e sigurimit të tenderit nga grupi i OE, duke eliminuar ofertën e tyre në mënyrë të qëllimshme. Për të mbështetur këtë pretendim, ata prezantojnë si provë politikën e sigurimit të tenderit, e cila është bashkangjitur si dëshmi. Ndërsa tek pretendimi i pestë AK ka shpallur fitues ofertën e OE, ASTRAPLAN, megjithatë, pas ekzaminimit dhe vlerësimit të dokumentacionit, konstatohet mungesa e dokumentacionit të kërkuar. OE ankuesi kërkon që eksperti shqyrtues të rishqyrtojë dokumentacionin për të vërtetuar plotësimin e kriterëve të kërkuara në dosjen e tenderit.

Përgjigje ne kërkesën për rishqyrtim nga AK:

Pretendimi i tenderuesit ankues Grup i OE, EBK SH.P.K. & PRO ARK CONSTRUCTION SH.P.K.& N.P.N. UNIVERS-MI, Prizren, se AK me rastin e vlerësimit të tenderëve, ka shkelur Neni 7 i LPP-së - Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi, sepse me rastin e vlerësimit të tenderëve, ka diskriminuar kompaninë tonë është i pabazuar. Autoriteti Kontraktues, Juve ju ka eliminuar, pasi që nuk keni dorëzuar tender të përgjegjshëm. Tenderi i juaj është administrativisht i papërgjegjshëm, për arsye se gjatë procedurës së ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve, komisioni i ri-vlerësimit ka konstatuar se Ju nuk e keni dorëzuar-vazhduar Sigurimi i tenderit, në pajtueshmëri me kërkesën e nga AK, ku ka kërkuar të gjithë tenderucsit vazhdimin e validitetit të ofertave dhe sigurimin e tenderit. Andaj në këtë rast nuk kemi të bëjë me shkelje të Nenit 7 të LPP-së.

Ministria e Punëve të Brendshme-ZPP pas pranimit të Kërkesës për rishqyrtim, ka shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore dhe ka ardhur në përfundim se nuk qëndron pretendimi i tenderuesit Grup i OE, EBK SH.P.K. & PRO ARK CONSTRUCTION SH.P.K.& N.P.N. UNIVERS-MI, Prizren, sepse gjatë procesit të vlerësimit të tenderit të këtij Tenderuesi AK ka vepruar në pajtueshmëri me Nenin 59 të LPP-së, ju ka përmbajtur dhe ka zbatuar nenin 59 par. 4 të LPP- së, citojmë: "Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Tenderi i juaj është administrativisht i papërgjegjshëm: Nuk i keni përmbushur kërkesat e sigurisë së tenderit; Nuk i keni përmbushur kërkesat e vlefshmërisë së tenderit; Kjo kërkesë- B47 Letra standarde e kërkesës për sqarimin e tenderit (vazhdimi i validitetit dhe sigurimit të tenderit), nga AK është ngarkuar me datë 02.02.2024 si vijon: Afati i kthimit të përgjigjes ka qenë 5 ditë nga data e kërkesës. Në e-prokurim shihet se nuk është dorëzuar-ngarkuar vazhdimi i validitetit të ofertave dhe sigurimi i tenderit brenda afatit të kërkuar nga AK-MPB e po ashtu edhe në momentin e shqyrtimit të kësaj kerkese nuk keni vlefshmeri të ofertës, mbi bazën e kësaj tenderi i Juaj është shpallur i papërgjegjshëm, meqenëse oferta juja është administrativisht e papërgjegjshme, komisioni nuk është lëshuar të vlerësim të mëtutjeshëm të tenderit tuaj dhe me të drejte ka vendosur për eliminimin e ofertës tuaj.

Eksperti shqyrtues lidhur me pretendimet e OE ankues ka deklaruar si vijon:

Ekspertja shqyrtuese, pas analizës së dokumentacionit, ka konstatuar se AK nuk ka kërkuar që operatori ekonomik të vazhonte validitetin e ofertës, ndaj eliminimi i tij në bazë të kësaj arsyeje

nuk mund të justifikohet ligjërisht. AK kishte eliminuar operatorin në rishqyrtim për arsye të tjera, por më pas e ka bërë këtë për shkak të mosvazhdimt të validitetit të ofertës, çka nuk është një pretendim i rregullt i procedurave të prokurimit publik. Në ankesë, operatori ekonomik ka sjellë edhe pretendime kundër operatorit ekonomik tjetër të rekomanduar, lidhur me mos hapjen e disa dokumentacioneve në ofertë. Megjithatë, AK ka kthyer lëndën në rishqyrtim duke kërkuar sqarime shtesë, duke u bazuar në nenin 72 të Ligjit të Prokurimit Publik, përpara se të merrte një vendim përfundimtar. Përmbledhtazi, rekomandohet që vendimi i AK-së të mbetet në fuqi, megjithëse ankesa e operatorit ekonomik konsiderohet pjesërisht e bazuar. AK ka eliminuar operatorin ekonomik dy herë me arsyetimin e njëjtë.

- Konstatimi i Panelit Shqyrtues –

Në fazën e shqyrtimit paraprak, OSHP ka konstatuar se ankesa në rastin konkret është parashtruar brenda afatit ligjor sikurse parashihet me nenin 109 paragrafi 1 dhe është ushtruar pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve, sikurse kërkohet edhe kjo në kuptim të nenit 108/A të LPP, megjithatë ankesa nuk i përmban të gjitha elementet qenësore të parapara me dispozitën e nenit 111 të LPP. Në të vërtetë sipas paragrafit 1.5 të nenit 111, kërkohet që ankuesi ta vërtetojë faktin, cituar: “se kualifikohet si “palë e interesuar” siç është përkufizuar kjo shprehje në nenin 4 të këtij ligji”. Kurse sipas nenit 4, paragrafi 1.26. parashihet shprehimisht se palë e interesuar, konsiderohet personi [nënkupto: fizik dhe/ose juridik] i cili siç thuhet, cituar “mund të dëshmojë interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit të zbatuar nga autoriteti kontraktues në raport me një kontratë të veçantë publike ose...”.

Andaj, OSHP pas shqyrtimit dhe realizimit të të gjitha provave dhe shkresave të lëndës, konstaton se për këtë procedurë të prokurimit OE “EBK” SH.P.K ka qenë ankues më parë në ankesë në OSHP, me numër të protokollit OSHP-së, me nr. 2023/876 me datën 29.01.2024, me të cilin vendimin e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e Operatorit Ekonomik **EBK SH.P.K.**, me të cilin OE ankues është cilësuar si i pa përgjegjshëm lidhur me aktivitetin e prokurimit andaj edhe është eliminuar nga pjesëmarrja.

Andaj OSHP pas shqyrtimit dhe analizimit të gjithë dokumentacionit të ankesës dhe procedurës se prokurimit në kontekstin shpjegimeve si me sipër, e posaçërisht duke i kushtuar kujdesin e duhur po ashtu dhe natyrës dhe qëllimit të pretendimeve ankimore, palëve në procedurë u konstatua se ankuesi cilësohet si palë pa interes juridik material, ku ndër të tjera vihet në zbatim neni 103 i LPP, sipas të cilit, "Dispozitat e kësaj pjese përcaktojnë të drejtat themelore dhe procedurale dhe mjetet juridike në dispozicion të palëve të interesuara siç është përkufizuar ky term ("palë e interesuar") në nenin 4 (të këtij ligji)". Kuptimi i kësaj dispozite vërteton fare qartë mendimin e OSHP- së, mjetet juridike mund të vihen në lëvizje vetëm nga palët e interesuara duke ju referuar në këtë rast pikërisht përkufizimit të dhënë në nenin 4 të LPP-së.

Në këtë rast, shikuar në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të kësaj lënde, rrjedhës së aktivitetit të prokurimit akteve dhe veprimeve të palëve të përfshira, është jo kontestues fakti se ankuesi është eliminuar nga ky aktivitet i prokurimit me vendimin tani të atakuar të autoritetit kontraktues. Mirëpo ankuesi nuk e ka atakuar vendimin e cituar si më sipër të autoritetit kontraktues mbi bazën e shkaqeve dhe arsyeve të cilat kërkohet shprehimisht me paragrafin 1.8. të nenit 111, të LPP, sipas të cilit kërkohet nga ankuesi, cituar: “të përshkruajë mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t’i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës...” Kështu, në kontekstin e shpjegimeve si më sipër, OSHP vëren se:

- se ankuesi nuk e ka ushtruar ankesë për të dëshmuar interesin material, të tij/saj, sikurse kërkohet kjo me paragrafin 1.26 të nenit 4;
- nuk e ka ushtruar ankesën në harmoni me paragrafin 1.8 të nenit 11, sipas të cilit kërkohet që të përshkruajë mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose mund t'i shkaktojë dëme materiale;

Duke i analizuar të gjitha këto, OSHP në këtë rast konsideron se duhet i referohet dispozitës së nenit 31, paragrafi 2, të Rregullores për punën e Organit Shqyrtues të Prokurimit, sipas të cilit, cituar: "...Paneli duhet ta konsideroj ankesën si të pa bazuar edhe nëse po të mos kishte asnjë shkelje të ligjit, ankuesi nuk do të kishte gjasa për fitimin e tenderit". Prandaj në rastin konkret, konstatohet se ankuesi nuk e ka statusin e palës së interesuar, i cili konsiderohet kusht i domosdoshëm për shqyrtimin dhe vendosjen meritore në kuptim të nenit 105 të LPP, sipas të cilit OSHP ka kompetenca, autoritet, pushtet dhe përgjegjësi, në kuadër të kushteve të saktësuara në këtë Pjesë IX që ti shqyrtojnë ankesat nga, cituar "palët e interesuara".

Nga të gjitha sqarimet e cekura si më lartë, OSHP e hedhë si të pa lejuar ankesën e parashtruar me datën 18.06.2024 me Nr. protokolli 0519/2024 nga OE "EBK" SH.P.K sepse ankesa për këtë procedurë të prokurimit, konsiderohet çështje e gjykuar sipas paragrafit 2.16 të nenit 105 të Ligjit për Prokurim Publik, ku thuhet: *"Në rastet e përsëritura me pretendimet e njëjta ankimore, kur objekti i kontestit dhe palët janë të njëjta, për raste të cilat janë shqyrtuar më parë, kryetari i panelit shqyrtues duhet të trajtoj si çështje të gjykuar "res judicata", dhe konfirmoj nënitet 4, 1. 26 të ligjit, OE ankues "EBK" SH.P.K me emrin tregtar konsiderohet si palë pa interes juridik për shkak se me vendimin 876/2024, i njëjti është konsideruar si i papërgjegjshëm cituar "Paneli Shqyrtues vëren se në ofertën e tij/saj nuk është bashkangjitur asnjë autorizim për kryerjen e veprimeve të caktuara juridike të ankuesit në emër dhe llogari të teknikut V.G. përderisa nuk është kontestuese po ashtu se kontrata e teknikut V.G. nuk është nënshkruar nga V.G. por nga një person tjetër në vend të tij. Lidhur me këtë, përfaqësuesi i OE ankues në seancën dëgjimore ka deklaruar se tekniku e kishte autorizimin pranuar vetëm në mënyrë verbale, gjë që sipas gjykimit të pavarur të këtij paneli, AK kishte vepruar drejtë kur kishte eliminuar ankuesin nga ky aktivitet, ngase të njëjtit sipas LPP-së mbajnë përgjegjësi për ofertën e tyre të dorëzuar pranë një autoriteti publik pikërisht në përputhje me të gjitha kërkesat dhe dëshmitë e kërkuara. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka gjetur se pretendimet ankimore të ankuesit "EBK" SH.P.K. janë të pabazuara në fakte dhe prova konkret", prandaj Ankuesi nuk mund të arrijë të dëshmojë se ka statusin e palës së interesuar sipas dispozitës 4, 1.26 të LPP-së.*

- Përfundim -

Bazuar shkurtimisht në shpjegimet si më sipër OSHP konsideron se ankuesi nuk e ka statusin e palës në këtë çështje, në mënyrën se si është rregulluar kjo shprehimisht me dispozitat e cituara si më sipër të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, prandaj OSHP nuk është lëshuar në shqyrtimin e përmbajtjes dhe pretendimeve, ngase ato në këtë rast konsiderohen me karakter jo relevant.

Sa i përket pohime të AK lidhur me mosvazhdimin e validitetit nga OE ankues, paneli sqaron po ashtu se bazuar në Ligjin për Prokurimin Publik (LPP) dhe rregulloret dytësore Nr.001/2022 neni 28 paragrafi 5,7, sa i përket sigurimit të ofertave paneli shqyrtues sqaron se nuk mund të aplikohet siguri retroaktiv, siç e konfirmon këtë edhe interpretimi nr. 7 i Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik (KRPP), i publikuar në faqen e tyre të internetit, megjithëse nuk përcaktohet një afat i saktë sa ditë përpara të kërkohet zgjatjen e validitetit të ofertës, thekson se

është e rëndësishme që të ketë një kontinuitet midis afateve, cituar: *"Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit duhet me kujdesin më të madh të përcjellë validitetin e ofertave, dhe në çdo rast duhet të kërkojë nga të gjithë operatorët ekonomik pjesëmarrës zgjatjen e validitetit të ofertave para datës së skadimit. Në mënyrë retroaktive nuk mund të kërkohej zgjatja e validitetit të ofertave dhe/ose e sigurisë së tenderit "*.Neni 30.3 i Rregullorës për prokurim publik Nr.001/2022, përcakton dhe kërkon që oferta të ketë validitet deri tek dhënia dhe nënshkrimi i kontratës, duke e bërë qartë se asnjë kontratë publike nuk mund të nënshkruhet me validitet të skaduar të ofertës, sipas shkresave të lëndës OE ankues ka shkeputhje tek validiteti i ofertave, kurse AK ka pohuar se i njeti [Ankuesi] nuk e ka vazhduar as sigurimin e tenderit, që realisht shpie edhe refuzimin e tij/saj si administrativisht i papërgjegjshëm për këtë aktivitet edhe mbi këtë arsye.

Sidoqoftë i mbetet Autoritetit Kontraktues që nga kuadri i kompetencave të tij në vështirësi të nenit 24 të LPP-së të kujdeset për ligjshmërinë e veprimeve nga kuadri i këtij aktiviteti të prokurimit në harmoni me dispozitën e cituar sipas së cilës: “Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj” e duke vazhduar me kujdesin e tij/saj në implementimin e drejtë të dosjes së tenderit dhe siç kërkohej me dispozitën e nenit 59 të LPP “të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit”

Meqë në kontekstin e pohimeve ankimore vërehet se ankuesi e ka atakuar vendimin e autoriteti kontraktues vetëm në raport me operatorin ekonomik të rekomanduar nuk përbën bazë të mjaftueshme për ta hapur procesin e administrimit të provave dhe/ose për ta anuluar eventalisht një vendim të tillë për faktin se ankuesi nuk është fitues i këtij tenderi . Në këtë rast duhet kujtuar se autoriteti kontraktues nga cilësia e tij si institucion i administratës publike ka kapacitetet organizative dhe profesionale dhe te drejtë që ta themeloj komisionin vlerësues i cili udhëhiqet nga përgjegjësia gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve, sikurse kërkohej kjo shprehimisht në paragrafin 1 të nenit 59 të LPP-së, e sipas dy komisioneve profesionale te vlerësimit të AK kishte rezultuar i njëjti si ofertues i papërgjegjshëm, njëherësh duke konstatuar se oferta e OE të r rekomanduar është në përputhje me gjitha kriteret e vendosura nga cilësia e saj si AK në DT.

Prandaj nisur nga të lartcekurat, e duke vepruar në bazë të nenit 102, lidhur me nenin 98, 99, 105 dhe 111 të LPP është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Për pikën 1 dhe 2 të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP. Për pikën 3 të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 118 të LPP lidhur me nenin 31 paragrafin 4 dhe 6 të Rregullores së Punës së OSHP dhe në kosnidtencë me vendimet paraprake të këtij isntitucioni.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vjosa Gradinaj

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të ushtrojë Padi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit në Gjykatës Komeriale/Departamenti për çështje Administrative në Prishtinë.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME**
- **OE - EBK SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: